



KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”

DEPARTAMENTI I GJUHËVE DHE LETËRSISË

FJALORI I ANASJELLË I GJUHËS SHQIPE

Mbikëqyrja: Msc. Theano Kostoli

Bashkëpunëtorë: Vasil Kasneci, Fatjon Postolli, Mateo Tauzi & Dorina Verushi

Renditja alfabetike: Vasil Kasneci

Tiranë

Botimi i parë, janar 2024

1. Hyrje

Fjalori i Anasjellë i Gjuhës Shqipe është një projekt kolektiv në formë elektronike me akses të hapur për të gjithë, që ka nisur në vitin 2020 në kuadër të lëndës së Gjuhësisë në Departamentin e Gjuhëve dhe Letërsisë të Kolegjit Universitar "LOGOS", pas konstatimit se gjuha shqipe nuk ka fjalor të anasjellë. Fjalori quhet i tillë, sepse lemat renditen sipas alfabetit duke nisur nga shkronja e fundit drejt shkronjës së fillimit, domethënë nga fundi drejt fillimit të fjalëve.

Pika e nisjes ishte *Fjalori i Anasjellë i Greqishtes së Re* (Anastasiadis-Symeonidis 2003). Me iniciativën e Prof. Anastasiadis-Symeonidis, ky projekt kolektiv iu caktua një grupi prej katër studentësh¹ të vitit të fundit të Kolegjit Universitar "LOGOS" nën mbikëqyrjen e pedagoges Theano Kostoli. Baza për hartimin e lematologjisë u bë *Fjalori autoritar i Gjuhës Shqipe i Akademisë së Shkencave të Tiranës* (2006), i cili përmban afërsisht 50.000 lema së bashku me lemat e nënrenditura (endolemat), të cilat dalin kur trajta lematike është folje. Këto lema i përkasin katër kategorive gramatikore: foljes në trajtën pësore, mbiemrit, emrit ose ndajfoljes. Gjatë nënrenditjes, rrënja e foljes ruhet në trajtën veprorë me shtimin e prapashtesave ose mbaresave në varësi të kategorisë së re. Në vazhdimësi këto lema u përfshinë në mënyrë të barabartë në *Fjalorin e Anasjellë të Gjuhës Shqipe* dhe u renditën sipas rendit të tyre alfabetik.

2. Fjalori i Anasjellë i Gjuhës Shqipe

Makrostruktura e fjalorit, pra lista e lemave të renditura sipas rendit të anasjellë alfabetik, është nxjerrë, siç u përmend, nga *Fjalori i Akademisë së Shkencave*. Dihet se fjalori i çdo gjuhe ndryshon më intensivisht dhe më shpejt se të gjitha nënsistemet e gjuhës (fonologji, morfologji, sintaksë, semantikë, pragmatikë), sepse ndjek më nga afër zhvillimin shoqëror. Megjithatë, asnjë fjalor nuk mund të përmbajë të gjithë pasurinë e një gjuhe, për arsye që i detyrohen edhe vetë gjuhës dhe natyrës së praktikës leksikografike, por edhe qëllimeve të çdo fjalori. Kjo dobësi korrigjohet deri diku nga ribotimet e përmirësuara dhe të shtuara të vazhdueshme të fjalorëve.

Mikrostruktura e fjalorit, pra tërësia e informacioneve që jepen për çdo lemë, përbën një pjesë të rëndësishme të punës leksikografike dhe përfshin informacione të koduara për çdo lemë të fjalorit, në lidhje me pjesën e ligjëratës, gjininë, numrin, trajtën etj. duke u bazuar te drejtshkrimi i *Fjalorit të Akademisë*. P.sh., te emri, të cilin e marrim gjithmonë në trajtën e pashquar dhe në rasën emërore, informacionet regjistrohen sipas kategorisë së tij, gjinisë dhe numrit të tij në trajtën e përbashkët. Një emër, kur përfshin të dyja gjinitë, shënohet në gjininë mashkullore, por në kodim shënohet se ka edhe gjini femërore (E:mfj) siç përcaktohet nga gramatika, ndërsa në rastin kur një emër tregon një objekt të dyfishtë (ka dy kuptime të ndryshme), përmendet dy herë.

Shembuj:

LEMA	SHKURTIMI
Mëngjes	E:mnj
Natë	E:fnj
Parë (Njëra nga të pesë shqisat)	E:asnj
Parë (Ai që është në krye të një pune)	E:mnj
Grumbuj	E:msh
Të korrat	E:assh

¹ Bëhet fjalë për studentët tashmë të diplomuar: Vasil Kasnecin, i cili mori përsipër edhe kryerjen e renditjes alfabetike në mënyrë të anasjellë; Faqjon Postollin; Mateo Tazuin dhe Dorina Verushin.

Perime	E: fsh
Fotoreporter	E: mfnj

Përsa i përket mbiemrave, njihen dy kategori mbiemrash: të nyjshëm dhe të panyjshëm, por kjo ndarje është sintaksore. Në kodimin e fjalorit mbiemrat e panyjshëm regjistrohen në njëjës të gjinisë mashkullore (Mb:mnj), ndërsa gjinia femërore jepet nga gramatika, por ka edhe një kodim të veçantë (Mb:fnj) për mbiemrat e panyjshëm që formojnë vetëm gjininë femërore. Ndërsa mbiemrat e nyjshëm, gjinia e të cilëve është specifikuar, janë të koduar në të njëjtën kategori (Mb:mfnj). Një kategori tjetër e mbiemrave është e ajo e të emëruarve. Në gjuhën shqipe mbiemri i emëruar dallohet formalisht nga emri nga prania e nyjes së paracaktuar. Kodimi i kësaj kategorie jep informacion për statusin gramatikor si mbiemër dhe emër dhe specifikon gjininë dhe numrin në gjendjen fillestare (Mb:mnj, E:mfnj).

Shembuj:

LEMA	SHKURTIMI
Mëngjarash	Mb:mnj – mbiemër i panyjshëm, gjinia mashkullore, numri njëjës
Normale	Mb:fnj – mbiemër i panyjshëm, gjinia femërore, numri njëjës
Mërzitur	Mb:mfnj – mbiemër i nyjshëm, gjinia mashkullore dhe femërore, numri njëjës
Pastërtor	Mb:mnj, E:mfnj – mbiemër i emëruar

Në rastin e foljes, kodimi bazohet te forma dhe përmban informacion për mënyrën, kohën dhe vetë formën. Jepen edhe foljet ndihmëse, gjysmëndihmëse dhe pavetore të cilat dallohen dhe kodohen si më poshtë: F:dtjv, F:dtv, F:gjnd, F:nd, F:pv.

Shembuj:

LEMA	SHKURTIMI
Mënjanohem	F:dtjv – folje në vetën e parë njëjës, dëftore, e tashme, forma joveprore
Mënjanoj	F:dtv – folje në vetën e parë, dëftore, e tashme, forma veprore
Kam	F:nd – folje ndihmëse
Mund	F:gjnd – folje gjysmëndihmëse
Duhet	F:pv – folje pavetore
Oshin	F:dtv – folje në vetën e tretë, dëftore, e tashme, forma veprore

Pjesët e tjera të ligjëratës regjistrohen në fjalor në formën e tyre të thjeshtë: Numëror, Përemër, Ndajfolje, Parafjalë, Lidhëz, Pjesëz, Nyje, Pashirmë etj.

3. Dobishmëria

Fjalori i Anasjellë i Gjuhës Shqipe është një mjet veçanërisht i dobishëm për një gjuhëtar që studion strukturën e fjalëve të gjuhës shqipe, sepse jep një pamje të vërtetë të strukturës së saj morfologjike, pasi një pjesë e madhe e informacionit morfologjik regjistrohet në fund të çdo fjale, të tilla si mbaresat gramatikore që përfshijnë lakimin dhe prapashtesat për të prodhuar fjalë të reja. Gjithashtu, ky fjalor ndihmon në krijimin e tabelave të shpeshtësisë statistikore të strukturave leksikore të gjuhës, p.sh., cilat mbaresa dalin më shpesh në fjalorin e shqipes. Së fundi, ky fjalor është shumë i dobishëm për poetët që kërkojnë fjalë që përfundojnë me një mbaresë të caktuar ose për epigrafologet që po shqyrtojnë tekste të ndryshme të dëmtuara ose të paplota, p.sh., mbishkrim guri

ose dokument i djegur që ka vetëm pjesën e fundit të një fjale. Fjalorë të anasjellë të këtij lloji janë botuar për shumicën e gjuhëve alfabetike.

4. Epilog

Fjalori i Anasjellë i Gjuhës Shqipe pasuron leksikografinë e gjuhës shqipe duke dhënë një pasqyrë të detajuar të strukturës morfologjike të gjuhës dhe është një mjet i dobishëm për kategoritë e ndryshme të përdoruesve që përmendëm, si gjuhëtarët, studiuesit e gjuhës, poetët, arkeologët, studentët etj.

Sot në gjuhën shqipe nuk ekziston një fjalor i tillë dhe përpjekja jonë për ta ofruar atë në këtë gjuhë është sa origjinale, aq edhe e dobishme. E gjithë puna jonë është bërë në mënyrë sistematike dhe bazuar në të dhënat e gjuhësisë.

Shpresojmë që përpjekja jonë të japë fryte të dobishme në fushën shkencore të gjuhësisë dhe ky fjalor do të shërbejë në shumë kërkime dhe zbatime.

BIBLIOGRAFIA

- Anastasiadis-Symeonidis Anna, 2003. *Reverse Dictionary of Modern Greek*. Thessaloniki: Institut of Modern Greek Studies.
- *Gramatika e Gjuhës Shqipe, Morfologjia*, 2002. Akademia e Shkencave V.I. Tiranë: Maluka.
- *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, 2006. Akademia e Shkencave. Tiranë: Akademia.
- *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, 1973. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- *Fjalor Etimologjik i Gjuhës Shqipe*, 2017. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

SHKURTIME

Shkurtime të përshkruajnë kategorinë gramatikore të lemave të *Fjalorit të Anasjellë të Gjuhës Shqipe* janë si vijon:

- E:asn – emër në gjininë asnjëse, numri njëjës
- E:assh – emër në gjininë asnjëse, numri shumës
- E:fnj – emër në gjininë femërore, numri njëjës
- E:fsh – emër në gjininë femërore, numri shumës
- E:mnj – emër në gjininë mashkullore, numri njëjës
- E:msh – emër në gjininë mashkullore, numri shumës
- E:mfj – emër në gjininë mashkullore dhe femërore, numri njëjës. Shkruhet vetëm gjinia mashkullore, sepse gjinia femërore parashikohet nga gramatika.
- F:dtjv – folje në vetën e parë ose në vetën e tretë njëjës, dëftore, e tashme, forma joveprore
- F:dtv – folje në vetën e parë ose në vetën e tretë njëjës, dëftore, e tashme, forma veprare
- F:gjnd – folje gjysmëndihmëse
- F:nd – folje ndihmëse
- F:pv – folje pavetore
- Fj.u. – fjalë e urtë
- Fraz. – shprehje frazeologjike
- Lidh. – lidhëz
- Mb:fnj – mbiemër i panyjshëm, gjinia femërore, numri njëjës
- Mb:mfj – mbiemër i nyjshëm, gjinia mashkullore dhe femërore, numri njëjës
- Mb:mnj – mbiemër i panyjshëm, gjinia mashkullore, numri njëjës
- Ndajf. – ndajfolje
- Num. – numëror
- Nyj. – nyje
- Onomat. – onomatope
- Palak. – i palakueshëm
- Parafj. – parafjalë
- Parasht. – parashtesë
- Psth. – pasthirmë
- Përem. – përemër
- Pj. – pjesëz
- Pjes. – pjesore
- Prapasht. – prapashtesë
- Shkurt. – shkurtim